

Prishtina 01/12/2005

**Kodi i ZRRE-së: D\_08\_2005**

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit Nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”;
2. Dispozitat e Ligjit Nr. 2004/10 “ Mbi Energjinë Elektrike”;
3. Propozimi i dorëzuar nga Korporata Energjetike e Kosovës (“KEK”) tek Zyra e Rregullatorit të Energjisë (“ZRRE”), komentet e dorëzuara në KEK dhe përgjigja e KEK-ut më 21 nëntor 2005 dhe 25 nëntor 2005;
4. Komentet mbi propozimin e dhënë nga ZRRE-ja më 18 nëntor 2005;

Në sesionin e mbajtur më 29 nëntor 2005, ka vendosur që:

- a) **Aprovojë kërkesën e KEK-ut në lidhje me politikën ABC bazuar në kërkesën dhe bashkëngjitjet e futura në version e nënshkruar të këtij Vendimi**

### **Kapitulli 1: Politika ABC**

1. Bordi i ZRRE-së ka rishqyrtuar politikën ABC të dorëzuar nga KEK-u dhe ka vendosur ta aprovojë me disa kushte:
  - a) KEK-u do t’i sigurojë ZRRE-së informacione të qarta mbi numrin e konsumatorëve të mirë (kategoria A) dhe atyre të ulët ose që nuk paguajnë (kategoritë B & C) në çdo furnizues.
  - b) KEK-u do t’i dorëzojë çdo Komune të prekur nga programi C, listën e konsumatorëve mos-pagues ose konsumatorëve që paguajnë pak, dhe prej çdo furnizuesi. Komuna në bashkëpunim me KEK-un do të informojë siç duhet, këta konsumatorë mbi politikën dhe pasojat e mos-pagimit ose përdorimit të paligjshëm të energjisë.
  - c) KEK-u do të marrë të gjithë masat e mundshme për të siguruar furnizuesit e dedikuar, të kërkuar nga konsumatorët e mirë-që paguajnë, të cilët e gjejnë veten në kategorinë C, në

- grupin tarifor 6 e përpjetë, në rast se këta konsumatorë i kërkojnë këto. KEK-u do t'i dorëzojë ZRRE-së një propozim mbi tarifën e ri-lidhjes me mundësinë për të ndarë pjesëmarrjen në këto tarifa, mes KEK-ut dhe Konsumatorit.
- d) Sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se fundi i janarit 2006, KEK-u do t'i dorëzojë ZRRE-së për aprovim, propozimin e vet për kompensimin e Konsumatorëve të mirë që paguajnë, të cilët janë brenda zonave të klasifikuara si B ose C;
  - e) Gjatë zbatimit të politikës ABC, KEK-u do t'i trajtojë me mënyrë të barabartë, jo diskriminuese dhe të qëndrueshme të gjithë konsumatorët në Kosovë;
  - f) Gjatë zbatimit të kësaj politike, KEK-u do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, përfshirë masat disiplinore të stafit përgjegjës për veprimet kontrolluese, në mënyrë që të zbatojnë politikën ABC, pra që të shmangin rrezikun e dështimit dhe të arrijnë rezultatet e duhura;
  - g) KEK-u do të vazhdojë të aplikojë shkëputjen individuale për Konsumatorët mos-pagues dhe/ose ata që janë të lidhur ilegalisht (Vendimi Nr. D\_02\_2005 i ZRRE-së) dhe do të monitorojë nga afër punën e ekipeve të shkëputjes, si dhe do të zbatojë rregulla të rrepta disiplinore në rastin e moszbatimit ose zbatimit kundrejt politikës ABC, Vendimin mbi Shkëputjen dhe legjislacionin tjetër të aplikueshëm;
  - h) Menjëherë pas aprovimit të kësaj politike, KEK-u do të krijojë shërbimin për informimin e konsumatorëve që do të merret me ankesat e konsumatorëve dhe do të informojë konsumatorët mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.;
  - i) KEK-u do të informojë ZRRE-në në baza dy mujore, mbi arritjet e politikës ABC, përfshirë informacionin mbi numrin e ankesave të Konsumatorëve, bazuar në kategoritë e tyre dhe në numrin e ankesave të zgjidhura/të pazgjidhura;
  - j) KEK-u do të vazhdojë fushatën mbi marrëdhëniet publike në nivele të ndryshëm, përfshirë vetëdijësimin publik në nivel lokal dhe në komunitet;
2. Ky Vendim dhe Bashkëngjitjet në këtë Vendim, i janë dorëzuar KEK-ut në versionin origjinal dhe në datën e botimit të tij në faqen zyrtare elektronike.
  3. KEK-u do të fillojë të zbatojë këtë Vendim brenda pesë (5) ditëve punuese, sipas afatit përfundimtar të përcaktuar në paragrafin 5. KEK-u tashmë ka filluar të procedojë me fushatën publike dhe për më tepër, me programin e zbatimit përpara se t'i jepej Aprovimi i Rregullatorit për politikën e vet. KEK-u është i detyruar të kërkojë aprovimin e Rregullatorit përpara çdo njoftimi, ose përndryshe ekspozohet ndaj rreziqeve të reputacionit në rast se një politikë e shpallur publikisht nuk është zbatuar.
  4. Ky vendim do të botohet nga KEK-u në faqen e tij zyrtare dhe në të paktën një gazetë ditore lokale me qarkullim të gjerë në Kosovë, pesë (5) ditë pune pasi ka hyrë në fuqi.
  5. KEK-u ka të drejtë të paraqesë një apel për ZRRE-në kundër këtij Vendimi, duke dorëzuar një raport plotësisht të qëndrueshëm, brenda katërmëdhjetë (14) ditë punë pas njoftimit dhe botimit të këtij vendimi në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.

6. Ky vendim nxirret në versionin shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje midis tre versioneve, do të mbizotërojë version në anglisht.

## **Kapitulli 2: Kërkesa e KEK-ut dhe Bashkëngjitjet mbi Politikën ABC**

Në emër të Bordit të ZRRE-së

---

**Dr. Nick F Frydas**  
Kryesues i Bordit të ZRRE-së